

**DIREKTIVA NR. 97/75/KE, QË NDRYSHON DHE ZGJERON, PËR  
MBRETËRINË E BASHKUAR TË BRITANISË SË MADHE DHE IRLANDËS SË  
VERIUT, DIREKTIVËN E KËSHILLIT NR. 96/34 MBI MARRËVESHJEN  
KUADËR MBI LEJEN PRINDËRORE TË REALIZUAR  
NGA UNICE, CEEP DHE ETUC**

*(15 dhjetor 1997)*

Këshilli i Bashkimit Evropian ,

Duke pasur parasysh Traktatin themelues të Bashkimit Evropian dhe në veçanti Nenin 100 të tij,

Duke pasur parasysh propozimin nga Komisioni,

Duke pasur parasysh Opinionin nga Parlamenti Evropian,

Duke pasur parasysh Opinionin e Komitetit Ekonomik dhe Social,

Ndërkohë që Këshilli duke vepruar në përputhje me Marrëveshjen mbi politikën sociale, bashkëlidhur Protokollit 14, dhe në veçanti nenit 4(2) të saj, miratoi Direktivën e Këshillit nr. 96/34;

Ndërkohë që, si rezultat, Direktiva në fjalë nuk zbatohet në Mbretërinë e Bashkuar të Britanisë së Madhe dhe Irlandës së Veriut;

Ndërkohë që Këshilli Evropian i Amsterdami, i mbajtur në datat gjashtëmbëdhjetë dhe shtatëmbëdhjetë korrik njëmijë e nëntëqind e nëntëdhjetë e shtatë, vuri në dukje me miratimin e marrëveshjes së Konferencës Ndërqeveritare, përfshirjen e Marrëveshjes mbi politikën sociale në Traktat dhe gjithashtu vuri në dukje që duhej gjetur një mënyrë që t'i jepnin fuqi ligjore, dëshirës së Mbretërisë së Bashkuar dhe Irlandës së Veriut që të pranonte Direktivën tashmë të miratuar mbi bazën e asaj Marrëveshje para nënshkrimit të Traktatit të Amsterdami;

Ndërkohë që kjo Direktivë kërkon të arrijë këtë synim duke zgjeruar Direktivën e Këshillit nr. 96/34, për Mbretërinë e Bashkuar;

Ndërkohë fakti që Direktiva nr. 96/34 nuk zbatohet në Mbretërinë e Bashkuar, ndikon direkt në funksionimin e tregut të përbashkët;

Ndërkohë që zbatimi i marrëveshjes kuadër, bashkëlidhur Direktivës në fjalë, dhe në veçanti parimi i bashkërendimit të përgjegjësive prindërore dhe profesionale të prindërve punëtorë, në të gjitha shtetet anëtare do të përmirësojë funksionimin e tregut të brendshëm;

Ndërkohë që zbatimi i marrëveshjes kuadër synon, në veçanti, arritjen e objektivit të parimit të trajtimit të barabartë midis burrit dhe gruas në lidhje me mundësitë e punësimit dhe trajtimit në punë, dhe bashkërendimit të jetës familjare dhe asaj të punës;

Ndërkohë që miratimi i kësaj Direktive do ta bëjë të zbatueshme Direktivën nr. 96/34 në Mbretërinë e Bashkuar;

Ndërkohë që, nga data e hyrjes në fuqi të kësaj Direktive, termi “shtetet anëtare” në Direktivën e Këshillit nr. 96/34, do të interpretohet duke përfshirë dhe Mbretërinë e Bashkuar,

Ka miratuar këtë Direktivë:

### **Neni 1**

Pa cenuar nenin 2, Direktiva e Këshillit nr. 96/34 do të zbatohet për Mbretërinë e Bashkuar të Britanisë së Madhe dhe Irlandën e Veriut.

### **Neni 2**

Në Direktivën e Këshillit nr. 96/34 do të përfshihet paragrafi i mëposhtëm:

'1a. Për sa i përket Mbretërisë së Bashkuar të Britanisë së Madhe dhe Irlandës së Veriut, data tre qershor njëmijë e nëntëqind e nëntëdhjetë e tetë në paragrafin 1 do të zëvendësohet nga data pesëmbëdhjetë dhjetor njëmijë e nëntëqind e nëntë'

### **Neni 3**

Kjo Direktivë i adresohet shteteve anëtare.

## **DIREKTIVA NR. 97/80/KE, MBI BARRËN E PROVËS NE RASTET E DISKRIMINIMIT TË BAZUAR NË GJINI**

*(15 dhjetor 1997)*

Këshilli i Bashkimit Evropian,

Duke pasur parasysh Marrëveshjen mbi Politikën Sociale, bashkëlidhur Protokollit 14, mbi politikën sociale, bashkëngjitur Traktatit të Komunitetit Evropian dhe në veçanti nenit 2(2) të tij,

Duke pasur parasysh propozimin nga Komisioni,

Duke pasur parasysh Opinionin e Komitetit Ekonomik dhe Social,

Duke vepruar në përputhje me procedurën e vendosur nga Neni 189c të Traktatit, në bashkëpunim me Parlamentin Evropian,

1. Ndërkohë që, duke u bazuar në Protokollin mbi politikën sociale, bashkëlidhur Traktatit, shtetet anëtare, me përjashtim të Mbretërisë së Bashkuar të Britanisë së Madhe dhe Irlandës së Veriut (këtej e tutje të quajtur shtetet anëtare), me dëshirën për të zbatuar Kartën Sociale të vitit njëmijë e nëntëqind e tetëdhjetë e nëntë, kanë lidhur një Marrëveshje mbi politikën sociale;

2. Ndërkohë që Karta e Komunitetit mbi të Drejtat Sociale Themelore të Punëtorëve, njeh rëndësinë e luftimit të çdo forme të diskriminimit, duke përfshirë diskriminimin me bazë gjininë, ngjyrën, racën, opinionet dhe besimet;

3. Ndërkohë që paragrafi 16 i Kartës së Komunitetit mbi të Drejtat Sociale Themelore të Punëtorëve mbi trajtimin e barabartë për burrin dhe gruan, parashikon ndër të tjera, se “duhen shtuar veprimet për të siguruar zbatimin e parimit të trajtimit të barabartë për burrin dhe gruan, për sa i përket, në veçanti, aksesit në punë, pagesës, kushteve të punës, mbrojtjes sociale, arsimimit, formimit profesional dhe zhvillimit të karrierës’;

4. Ndërkohë që, në përputhje me nenin 3(2) të Marrëveshjes mbi politikën sociale, Komisioni ka këshilluar organizatat e punëdhënësve dhe punëmarrësve në nivel Komunitar, mbi drejtimin e mundshëm të veprimit të Komunitetit mbi barrën e provës në rastet e diskriminimit të bazuar në gjini;

5. Ndërkohë që Komisioni, duke marrë në konsideratë veprimin Komunitar të rekomandueshëm pas këshillimeve të tilla, kanë këshilluar edhe një herë organizatat e punëdhënësve dhe punëmarrësve, mbi përmbajtjen e propozimit të parashikuar në përputhje me nenin 3(3) të së njëjtës Marrëveshje;

6. Ndërkohë që, këta të fundit, i kanë dërguar opinionet e tyre Komisionit;

7. Ndërkohë që, pas raundit të dytë të këshillimit, asnjëra nga organizatat e punëdhënësve dhe punëmarrësve nuk kanë informuar Komisionin, për dëshirën e tyre për të filluar procesin, për të shkuar mundësisht drejt një marrëveshje, të parashikuar në nenin 4 të së njëjtës Marrëveshje;

8. Ndërkohë që, në përputhje me nenin 1 të Marrëveshjes, Komuniteti dhe shtetet anëtare kanë përcaktuar si objektivë të tyre, ndër të tjera, përmirësimin e jetesës dhe kushteve të punës;

9. Ndërkohë që zbatimi efektiv i parimit të trajtimit të barabartë për burrin dhe gruan mund të kontribuojë në arritjen e atij qëllimi;

10. Ndërkohë që parimi i trajtimit të barabartë për burrin dhe gruan është deklaruar në nenin 119 të Traktatit, në Direktivën e Këshillit nr. 75/117/KEE, të datës dhjetë shkurt njëmijë e nëntëqind e shtatëdhjetë e pesë, mbi përafrimin e ligjeve të shteteve anëtare lidhur me zbatimin e parimit të trajtimit të pagës së barabartë për burrin dhe gruan dhe në Direktivën e Këshillit nr. 76/207/KEE, të datës nëntë shkurt njëmijë e nëntëqind e shtatëdhjetë e gjashtë mbi zbatimin e parimit të trajtimit të barabartë për burrin dhe gruan për sa i përket aksesit në punë, formimit profesional dhe ngritjes në detyrë dhe kushteve të punës;

11. Ndërkohë që Direktiva nr. 95/85/KEE, e datës nëntëmbëdhjetë tetor njëmijë e nëntëqind e nëntëdhjetë e dy, mbi paraqitjen e masave për inkurajimin e përmirësimit të kushteve të shëndetit dhe sigurisë në punë të grave shtatzëna punëtore dhe punëtoreve të cilat kohët e fundit kanë lindur fëmijë, ose që ushqejnë me gjí foshnjën, kontribuon gjithashtu në zbatimin efektiv të parimit të trajtimit të barabartë për burrin dhe gruan;

12. Ndërkohë që Direktiva nuk duhet të veprojë në cenim të Direktivave të lartpërmendura mbi trajtimin e barabartë;

13. Ndërkohë që, për më tepër, punëtorët femra të mbuluara nga kjo Direktivë duhet në të njëjtën mënyrë të përfitojnë nga përshtatja e rregullave mbi barrën e provës;

14. Ndërkohë që Direktiva e Këshillit nr. 96/34, e datës tre qershor njëmijë e nëntëqind e nëntëdhjetë e gjashtë, mbi marrëveshjen kuadër mbi lejen prindërore të realizuar nga UNICE, CEEP dhe ETUC, është e bazuar gjithashtu mbi parimin e trajtimit të barabartë për burrin dhe gruan;

15. Ndërkohë që referencat në “procesin gjyqësor” dhe “gjykatë” sigurojnë mekanizma me anë të cilave mosmarrëveshjet, mund t’i nënshtrohen shqyrtimit dhe vendimit të strukturave të pavarura, të cilat mund të marrin vendime që janë të detyrueshme për palët në konflikt;

16. Ndërkohë që shprehja “jashtë procedurave të gjykatës” do të thotë procedura të veçanta të tilla si pajtimi dhe ndërmjetësimi;

17. Ndërkohë që vlerësimi i fakteve nga të cilat mund të prezumohet se ka pasur diskriminim direkt apo indirekt, është një çështje e gjyqësorit kombëtar apo e strukturave të tjera kompetente, në përputhje me ligjin ose praktikën kombëtare;

18. Ndërkohë që janë shtetet anëtare që paraqesin, në çdo lloj faze të përshtatshme të procedimit, provat të cilat janë më të favorshme për paditësin;

19. Ndërkohë që është e domosdoshme të merren parasysh tiparet specifike të disa sistemeve ligjore të shteteve anëtare, ndërmjet të tjerash, kur është nxjerrë një konkluzion për diskriminimin, nëse i padituri nuk arrin të paraqesë prova që bindin gjykatën apo një autoritetet tjetër kompetent se nuk ka pasur shkelje të parimit të trajtimit të barabartë;

20. Ndërkohë që shtetet anëtare nuk e kanë të nevojshëm zbatimin e rregullave të barrës së provës në procese, në të cilat është gjykata apo një autoritet tjetër kompetent që duhet të hetojë për faktet e çështjes;

21. Ndërkohë që procedurat e referuara, janë ato ku paditësit nuk i kërkohet të provojë faktet, për të cilat duhet të hetojë gjykata apo një autoritet tjetër kompetent;

22. Ndërkohë që paditësi mund të privohet nga çdo mjet efektiv për zbatimin e parimit të trajtimit të barabartë para gjykatave kombëtare, nëse efekti i paraqitjes së provave të një diskriminimi të dukshëm, nuk është për t'i imponuar të paditurit barrën e të provuarit që praktika e tij nuk është në fakt diskriminuese;

23. Ndërkohë që Gjykata e Drejtësisë e Komunitetit Evropian ka mbajtur qëndrimin se rregullat mbi barrën e provës duhet të përshtaten kur ekziston në pamje të parë një rast diskriminimi dhe se, për zbatimin efektiv të parimit të trajtimit të barabartë, barra e provës duhet t'i transferohet paditësit kur është sjellë prova e një diskriminimi të tillë;

24. Ndërkohë që është gjithmonë më e vështirë për të provuar diskriminimin kur është indirekt;

25. Ndërkohë që është e rëndësishme që të përcaktohet diskriminimi indirekt;

26. Ndërkohë që synimi për miratimin në mënyrë adekuate të rregullave mbi barrën e provës, nuk është arritur në mënyrë të mjaftueshme në të gjitha shtetet anëtare dhe, në përputhje me parimin e subsidiaritetit, siç parashikohet në nenin 3b të Traktatit, dhe me atë të proporcionalitetit, ai synim duhet të arrihet në nivel Komunitar;

27. Ndërkohë që kjo Direktivë e kufizon vetveten në veprimet më minimale të kërkuara dhe nuk mund të tejkalojë atë çfarë është e domosdoshme për arritjen e këtij objekti;

Ka miratuar këtë Direktivë:

## **Neni 1** **Qëllimi**

Qëllimi i kësaj Direktive është të sigurojë se të gjitha masat e marra nga shtetet anëtare për zbatimin e parimit të trajtimit të barabartë të jenë më efektive, në mënyrë që t'i mundësojë, të gjithë personave që janë dëmtuar për shkak të mos zbatimit të parimit të trajtimit të barabartë ndaj tyre, për të kërkuar të drejtat e tyre në proceset gjyqësore pas adresimit të mundshëm tek strukturat e tjera kompetente.

## **Neni 2** **Përkufizimet**

1. Për qëllimet e kësaj Direktive, parimi i trajtimit të barabartë do të kuptohet se nuk duhet të ketë diskriminim, direkt ose të indirekt, të bazuar në gjini.

2. Për qëllimet e parimit të trajtimit të barabartë të referuar në paragrafin 1, diskriminimi indirekt do të ekzistojë kur një dispozitë neutrale në dukje, kriteret apo praktika, krijon disavantazhe të një shkallë të lartë, për personat e një gjinie, përveç rasteve kur dispozita, kriteret apo praktika janë të përshtatshme dhe të justifikuara nga faktorë objektivë që nuk kanë lidhje me gjininë.

### **Neni 3**

#### **Fusha e zbatimit**

1. Kjo Direktivë do të zbatohet për:

a. rastet e mbuluara nga Neni 119 i Traktatit dhe nga Direktiva nr. 75/117/KEE, 76/207/KEE dhe, për sa i përket diskriminimit të bazuar në gjini, nga Direktiva 92/85/KEE dhe 96/34/KE;

b. çdo procedurë civile ose administrative të lidhur me sektorin publik ose privat, e cila parashikon mjete për rregullimin sipas ligjit kombëtar në përputhje me masat e referuara në paragrafin (a), me përjashtim të procedurave jashtë gjyqësore të një natyre vullnetare ose të parashikuara në ligjin kombëtar.

2. Kjo Direktivë nuk zbatohet në procedurat penale, përveç se kur parashikohet ndryshe nga shtetet anëtare.

### **Neni 4**

#### **Barra e provës**

1. Shtetet anëtare do të marrin masa të tilla që janë të nevojshme, në përputhje me sistemet gjyqësore kombëtare të tyre, për të siguruar që, kur personat të cilët e konsiderojnë veten të dëmtuar për shkak të moszbatimit të parimit të trajtimit të barabartë ndaj tyre, para gjykatës dhe ndonjë autoriteti tjetër kompetent, për faktet nga të cilat pretendohet të ketë pasur një diskriminim direkt ose indirekt, do të jetë i padituri që do të ketë barrën e provës për të provuar se nuk ka pasur shkelje të parimit të trajtimit të barabartë.

2. Kjo Direktivë nuk ndalon shtetet anëtare të paraqesin prova të cilat janë më të favorshme për paditësit.

3. Shtetet anëtare nuk duhet të zbatojnë paragrafin 1, në procese në të cilat është gjykata apo ndonjë strukturë tjetër kompetente, që heton mbi faktet e çështjes.

### **Neni 5**

#### **Informimi**

Shtetet anëtare do të sigurojnë që masat e marra në zbatim të kësaj Direktive, bashkë me dispozitat e lidhura me to, që janë tashmë në fuqi, të sillen në vëmendjen e të gjithë personave të interesuar, nëpërmjet të gjitha mjeteve të përshtatshme.

## **Neni 6 Garancitë**

Zbatimi i kësaj Direktive në asnjë rast nuk përbën bazë të mjaftueshme për reduktimin e nivelit të përgjithshëm të mbrojtjes së punëtorëve në fushat për të cilat ajo zbatohet, pa cenuar këtu të drejtën e shteteve anëtare për t'iu përgjigjur ndryshimeve të rasteve duke parashikuar ligje, rregullore dhe procedura administrative të cilat ndryshojnë nga ato që kanë qenë në fuqi në momentin e njoftimit të kësaj Direktive, me kushtin që të sigurohet respektimi i kërkesave minimale të kësaj Direktive.

## **Neni 7 Zbatimi**

Shtetet anëtare do të miratojnë ligjet, rregulloret dhe procedurat administrative të nevojshme për zbatimin e kësaj Direktive, brenda datës një janar dymijë e një. Pas kësaj, ata do të informojnë menjëherë Komisionin.

Kur shtetet anëtare të kenë miratuar masa të tilla, ato duhet të përmbajnë referenca me këtë Direktivë ose të jenë të shoqëruara nga referenca të tilla në rastet e publikimit të tyre zyrtar. Metodatat për realizimin e referenca të tilla përcaktohen nga shtetet anëtare.

Shtetet anëtare, brenda dy vjetëve nga hyrja në fuqi e kësaj Direktive, do t'i komunikojnë Komisionit, të gjithë informacionin e nevojshëm për hartimin e një raporti, për Parlamentin Evropian dhe Këshillin mbi zbatimin e kësaj Direktive.

## **Neni 8**

Kjo Direktivë i adresohet shteteve anëtare.